



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 23.05.2023

Nr: 131

Ora: 14:00

VENDIM I NDËRMJETËM

PËR SHQYRTIMIN BASHKËRISHT TË KËRKESAVE ANKIMORE NR. 63, DATË 22.05.2023 DHE NR. 70, DATË 22.05.2023

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 23.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Anëtar
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 63, datë 22.05.2023 dhe nr. 70, datë 22.05.2023

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 19 të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 23.05.2023 Nr: 131
Ora: 14:00



Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 63, datë 22.05.2023 dhe nr. 70, datë 22.05.2023

VËREN:

Partia “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave ankimore me nr. 63 regj., datë 22.05.2023.

Partia “Aleanca Progresiste LZHK” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave ankimore me nr. 70 regj., datë 22.05.2023.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, në datën 23.05.2023, me vendimet nr. 126 dhe nr. 130, vendosën të kalonin për shqyrtim dy kërkesat e paraqitura në KQZ. Relatorët ekërkesave ankimore përkatësisht z. Elvis Çefa dhe z. Ledio Braho konstatuan se të dy kërkesat kishintë njëjtin objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 260, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 07, Pukë “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Pukë”, si dhe rinumërim dhe rivlerësim i votave në QV-të e KZAZ 07, bashkia Pukë.

Përsa më sipër, KAS-i vendos bashkimin e kërkesave nr. 63 dhe nr. 70 dhe të shqyrtohen në një seancë. Duke qenë se kërkesa ankimore nr. 63, është regjistruar më parë në regjistrin e ankimimeve se kërkesa ankimore nr. 70, datë 22.05.2023, atëherë të dy kërkesat ankimore do të relatohen nga z. Elvis Çefa.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “dh” dhe 132 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 19 pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”,

VENDOSI:

1. Shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 63, datë 22.05.2023 dhe nr. 70, datë 22.05.2023.

Data: 23.05.2023 Nr: 131
Ora: 14:00



Për shqyrtimin bashkërisht të kërkesave ankimore nr. 63, datë 22.05.2023 dhe nr. 70, datë 22.05.2023

2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 24.05.2023 ora 12:30.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio BRAHO - Anëtar

Elvin LAKO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar